REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 298, Datë 20.10.2026

MBI

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 01, DATË 06.01.2025 "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "3AD ENERGY" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026, "*Për sektorin e energjisë elektrik*e"; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe nenit 15, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3061 prot., datë 13.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës*"Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 01, datë 06.01.2025"Mbi licencimin e shoqërisë "3AD Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",*

Konstatoi se:

1. **Të dhëna mbi shoqërinë "3AD Energy" sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin 01, datë 06.01.2025, vendosi të licencojë shoqërinë "3AD Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, Fshati Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se *Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune, shoqëria duhet të depozitojë në ERE amendimin e Kontratës së sipërmarrjes për kryerjen e punimeve, ku të përcaktohen afatet konkrete për likujdimin e vlerës kontraktore*, kurse në pikën 3 përcaktohet se *Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 26.04.2027*.

2. **Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Në kuadër të rakordimit të zbatimit të kushteve të vendimit të sipërcituar, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 01/2025 dhe i ka sjellë në vëmendje depozitimin e sa kërkuar në pikën 2 të këtij vendimi, sipas afatit të përcaktuar.
- Brenda afatit të përcaktuar në vendimin e bordit nr. 01/2025, shoqëria ka depozituar amendimin e kontratës, ku specifikohen dhe afatet konkrete për likujdimin e kontratës së sipërmarrjes. Me depozitimin e këtij dokumentacioni brenda afatit, rezulton se kushti i vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 01/2025 është plotësuar dhe vlerësohet të shfuqizohet.
- Nga ana tjetër, nga të dhënat që ERE disponon në kuadër të raportimeve mujore të depozituara nga shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" (FTL) sh.a., rezulton se shoqëria "3AD Energy" sh.p.k. ka hyrë në operim në muajin dhjetor 2025, pra brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të sipërcituar të bordit të ERE-s. Në këto kushte, vlerësohet se edhe pika 3 e vendimit nr. 01/2025, duhet të shfuqizohet.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.
- Në vijim të shfuqizimit të pikës 2 dhe 3 të vendimit nr. 01/2025, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4 të këtij vendimi, i cili përcakton se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, duke e riformuluar si vijon: "*Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi*".

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 01, datë 06.01.2025, si vijon:

   a) Pika 2 e vendimi, shfuqizohet.
   b) Pika 3 e vendimi, shfuqizohet.
   c) Pika 4 ndryshon dhe bëhet:

   4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "3AD Energy" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a., shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike" (ALPEX) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI